

**KONTRATË SHITJE KUOTASH
TË SHOQËRISË “FISH TIME” Sh.P.K.**

E lidhur në Tiranë, sot, më datë 14.12.2021, nga dhe ndërmjet:

Shitësi: **Artan Uzo**, shtetas shqiptarë, lindur me 08/01/1997 Sarandë dhe banuese në Tiranë, mbajtëse e leternjoftimit me nr. ID J70108107G, madhore e me zotësi të plote juridike e për të vepruar;

(në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si “Shitësi”);

dhe

Blerësi: **Haxhi Uzo**, shtetas shqiptarë, lindur me 09/11/1976 Livadhja Sarandë dhe banuese në Tiranë, mbajtëse e leternjoftimit me numër personal H61109048R, madhore e me zotësi të plote juridike e për të vepruar;

(në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si “Blerësi”);

Në vijim e për efekt të kësaj Kontrate, Shitësi dhe Blerësi do të referohen veçmas si Palë/a dhe së bashku si Palë/t.

MEQENËSE:

- a. Shoqëria “FISH TIME” Sh.P.K. (në vijim “Shoqëria”), shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar e që funksionon në përputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar pranë Qendres Kombëtare të Regjistrimit me Numër Unik Identifikimi NUIS L720170021, me kapital themeltar prej 100.000,00 Lekë, dhe sikurse rezulton nga regjistrimet në Regjistrin Tregtar Shitësi zotëron 100% të kuotave të kapitalit;
- b. Shitësi i ka njoftuar Blerësit ofertën e tij për shitjen e 100% të kuotave të kapitalit të zotëruara nga Shitësi në kapitalin themeltar të regjistruar të Shoqërisë dhe Blerësi ka pranuar të blejë kuotat e zotëruara dhe të ofruara nga Shitësi në Shoqëri;
- c. Në zbatim të kërkesave të Statutit të Shoqërisë dhe pas miratimit përkatës sipas Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, bashkëlidhur, Palët kanë vendosur të lidhin këtë Kontratë;

ATËHERË, duke qenë se ekzistojnë këto kushte paraprake, për të cilat Palët nuk kanë pretendime apo kundërshtime, Palët bien dakord për sa më poshtë vijon:

Neni 1 Objekti

Nëpërmjet kësaj Kontrate shitësi i shet Blerësit 100% të kuotave të kapitalit të Shoqërisë dhe Blerësi blen nga Shitësi 100% të kuotave të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 2 Çmimi

Çmimi i shitjes së 100% të kuotave të kapitalit të Shoqërisë është 1,500,000.00 lekë (Një milion e pesëqind mijë lekë). Çmimi i shitjes së kuotave i është paguar plotësisht Shitësit nga Blerësi përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate.



Haxhi Uzo
[Signature]

Neni 3 Deklarimet dhe garancitë

Shitësi deklaron se në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate ai zotëron kuotat që do të transferohen sipas kësaj Kontrate, dhe ka të drejtën për t'i transferuar këto kuota dhe se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Shitësi nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është Shitësi.

Blerësi deklaron se në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate Blerësi ka tagra të plota për të pranuar kuotat nga Shitësi sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate dhe se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Blerësi nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marreveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është Blerësi.

Neni 4 Transferimi i të drejtave mbi kuotat

Pronësia mbi kuotat e Shoqërisë, objekt i kësaj Kontrate, kalon nga Shitësi te Blerësi menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate. Kalimi i pronësisë së kuotave të Shoqërisë në favor të Blerësit do të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në përputhje me Ligjin 9901/2008, te ndryshuar dhe Ligjin 9723/2007, te ndryshuar.

Pas nënshkrimit të kësaj Kontrate, struktura e zotërimit të kapitalit themeltar të Shoqërisë do të jete si vijon:

Haxhi Uzo behet zotërues i 100% të kuotave të kapitalit;

Artan Uzo largohet nga shoqëria.

Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Blerësi gëzon të gjitha të drejtat për të regjistruar pronësinë mbi kuotat e zotëruara në emër të tij në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe pranë çdo institucioni tjetër shtetëror sipas legjislacionit në fuqi.

Per sa nuk parashikohet në kete Kontrate zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

Kjo Kontratë hartohet në gjuhën Shqipe në 2 kopje origjinale dhe nënshkruhet rregullisht si vijon:

SHITËSI

Artan Uzo

BLERËSI

Haxhi Uzo

